

V E N D I M
Nr.56, datë 4.2.1999

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR MBAJTJEN E ARMËVE NGA DREJTUESIT DHE
ORTAKËT E SHOQËRIVE TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 16 dhe 17 të ligjit nr.8388, datë 5.8.1998 “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Kanë të drejtë të paraqesin kërkesë dhe të pajisen me leje për mbajtje arme drejtuesit dhe ortakët e shoqërive tregtare, vendase a të huaja, të regjistruar në gjykatat shqiptare dhe që zotërojnë një kapital të përgjithshëm, jo më pak se pesëdhjetë milionë lekë ose kapital bankar jo më pak se njëzet milionë lekë.

2. Të pajisen me leje për mbajtje arme personat fizik të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, që plotësojnë kërkesat e nenit 9 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët” të kenë mbushur moshën 22 vjeç, të mos kenë të meta mendore e fizike dhe të mos kenë qenë më parë të dënuar për vepra penale.

3. Kërkesa për pajisje me leje për mbajtje armë paraqitet në komisariatet e policisë, ku ka vendbanimin aplikuesi i saj. Çdo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në ligj dhe në udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik.

4. Kërkesa për dhënien e lejes për të mbajtur armë, shqyrtohet nga komisioni i krijuar pranë çdo komisariati.

Në përfundim të procedurave, mbi bazën e vendimit të komisionit, kërkuuesi pajiset me lejen përkatëse, të nënshkruar nga drejtori i policisë së prefekturës.

Përbërja e komisionit, procedurat dhe afatet e shqyrtimit të kërkesave dhe modeli i lejes, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Rendit Publik.

5. Leja për mbajtje arme e dhënë nga organet e rendit publik është individuale dhe jepet vetëm për një armë.

6. Leja jepet vetëm për mbajtje arme brezi (pistoletë) ose krahu (automatik a pushkë).

7. Municioni për çdo armë të dhënë me leje të jetë: për pistoletën deri në 20 fishekë, automatikun deri në 200 fishekë dhe pushkën deri në 100 fishekë.

8. Për çdo armë të dhënë me leje e të regjistruar zbatohen këto tarifa:

-për pistoletën 2000 lekë në muaj;

-për automatikun dhe pushkën 1000 lekë në muaj.

9. Në rast humbjeje, vjedhjeje, grabitjeje të armëve të regjistruara e të dhëna me leje, shtetasit shqiptarë apo të huaj, janë të detyruar të bëjnë kallëzim në organet kompetente, brenda 24 orëve nga momenti i konstatimit.

10. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik të nxjerrë aktet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko